

Zingjirët e Vlerës për Komunën e Vitisë



Empowered lives.
Resilient nations.

United
Nations
Development
Programme

Viti
Grupi Lokal i Veprimit **Komuna e Vitisë**



Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (DBPZHR) dhe UNDP-Projekti INTERDEV 2, në emër të Grupit të Veprimit Lokal në Viti shpallin këtë:

THIRRJE PËR APLIKIM

Komuna e Vitisë dhe UNDP, në kuadrin e zbatimit të projektit të financuar nga Bashkëpunimi Austriak për Zhvillim (ADC), "Zhvillimi i Integruar Territorial 2" (InTerDev 2), kanë analizuar zingjirët e vlerës dhe akterët e përfshirë në Komunën e Vitisë. Qëllimi i kësaj analize ka qenë identifikimi dhe elaborimi i aspekteve aktuale të zingjirëve të vlerës. Krahas turizmit dhe bletarisë, janë identifikuar edhe dy sektorë me potencial, gjegjësisht ai i frutave dhe perimkulturës dhe bimëve malore.

Ky aktivitet është i planifikuar në përputhje me rekomandimet në kuadër të zingjirëve të vlerës dhe i dizajnuar për të mbështetur Komunën e Vitisë për të realizuar dhënien në formë granti të 1 dhome/komore ftohëse me dimensione 3m*5m*2.80m dhe 1 dhome/komore tharëse me dimensione 4m*3m*2.5m. Qëllimi i kësaj thirrjeje është ofrimi i mbështetjes për 2 shoqata ose ndërmarrje sociale, ose biznese të vogla të anagazuara në ruajtjen/përpunimin ose blerjen e perimkulturës dhe mbledhjen dhe tharjen bimëve mjekësore dhe aromatike. Ky aktivitet do të kontribuoj në krijimin e kapaciteteve shtesë të ruajtjes për prodhuesit e perimkulturës dhe mbledhësit e bimëve mjekësore dhe aromatike në komunën e Vitisë. Për tu kualifikuar për aplikim për këtë thirrje, shoqatat, ndërmarrjet sociale dhe bizneset e regjistruara individuale, duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

Kriteret e përshtatshmërisë

Për t'u kualifikuar, aplikantët duhet të jenë:

1. Të regjistruar si grup formal - SHOQATA, OSE Ndonjë FORMË TJETËR TË ORGANIZATAVE TË SHOQËRISË CIVILE / Ndërmarrje Sociale (sipas kornizës ligjore të Kosovës / LIGJI NR. 04 / L -057 PËR LIRINË E ASOCIIMIT NË ORGANIZATAT JOQEVERITARE); ose të regjistruar si biznese individuale të angazhuara në blerjen ose përpunimin e erimkulturës, bimëve mjekësore dhe aromatike në pajtim me ligjet e Kosovës (Ndërmarrja duhet të jetë e bazuar dhe operacionale në zonën e Komunës së Vitisë);
2. Grup formal, Shoqatë, Ndërmarrje sociale ose biznes individual, e vendosur dhe operative në Komunën e Vitisë;
3. Të vërtetojnë zyrtarisht përmes DOJQ (Departamenti i Organizatave Jo Qeveritare) ose zyrës për regjistrimin e bizneseve, me certifikatë / letër konfirmim se janë një grup/Shoqatë/Kooperativë/Ndërmarrje Shoqërore ose biznes individual aktiv dhe jo në listën e OJQ-ve lokale të penalizuara, dhe në rastin e Ndërmarrjes përmes ATK (Administrata Tatimore e Kosovës) dëshmojnë Certifikatën e fundit të të hyrave të brendshme/pagesën e taksave.

4. Dokumentojnë nga Ministria e Punëve të Brendshme se grupi formal/Shoqata/Kooperativa/Ndërmarrja Sociale, ose Biznesi Individual nuk është nën asnjë hetim / nuk është i përfshirë në asnjë aktivitet të paligjshëm; dhe
5. Të veprojnë në sektorin e perimkulturës ose bimëve mjekësore dhe aromtike (Përpunim, Ruajtje ose blerje), prodhim rural, zhvillimi ekonomik; (Të verifikohet nga Zyrtari Komunal Mbështetës i Projektit INTERDEV 2 dhe GLP në Viti)

Ju njoftojmë se këto janë kritere kualifikuese. Kjo do të thotë që nëse nuk përputhesh me njërin prej këtyre, do të diskualifikohesh gjatë kontrollit të kualifikimit dhe nuk shqyrtohet më tutje për vlerësim. Nëse keni dyshime për një ose më shumë kritere kualifikuese, ju lutemi konsultoni informacionin e dhënë në dosjen e aplikacionit apo kontaktoni **Zyrtarin Mbështetës të Projektit InTerDev 2 në Komunën e Vitisë**. (Zyra nr. 6, Ndërtesa e Kadastrës)

Së bashku me formularin e aplikimit, aplikantët e interesuar gjithashtu duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kopja e çertifikatës Valide të Çertifikates Valide të Rexhstrimit si grup formal, Shoqatë/Kooperativë/Ndërmarrje Sociale/Biznes Individual në Kosovë; (certifikata e lëshuar në pajtim me ligjet e Kosovës)
2. Kopja valide e Çertifikatës nga Administrata Tatimore e Kosovës sa i përket statusit të borxhit publik të aplikuesit që vërteton se Shoqata/Kooperativa/Ndërmarrja Sociale/Biznesi Individual nuk ka borxhe dhe nëse ka një borxh publik, ato duhen paguar para se të ofrohet mbështetja;
3. Kopja e statusit të OJQ-së/Shoqatës me listën e aktiviteteve dhe informacione për anëtarët; (vetëm për Shoqatat/Kooperativat/Ndërmarrjet Sociale; nuk nevojitet për bizneset e regjistruara individuale)
4. Kopja e raportit narrativ për vitin paraprak të OJQ-së/Shoqatës, përveq nëse organizata është themeluar këtë vit.
5. Kopja e letërnjoftimit të përfaqësuesit/ses së shoqatës, ndërmarrjes apo biznesit individual;

Përparësi në këtë Thirrje për Aplikim do t'u jepet shoqatave, kooperativave, Ndërmarrjeve Sociale ose Bizneseve Individuale që tashmë janë të përfshira në procesin e blerjes, ruajtjes dhe përpunimit të perimkulturës dhe bimëve mjekësore e aromatike dhe atyre që tashmë kanë disa kapacitete ekzistuese për ruajtje ose përpunim.

Si të merrni Formularin e Aplikimit:

Kopjet fizike të aplikacioneve mund të merren në zyrën e projektit të UNDP-së, INTERDEV 2 në Komunën e Vitisë zyra nr. 6 në Ndërtesën e Kadastrës.

Nëse ju duhen informata shtesë ose ndihmë për ta plotësuar formularët për aplikim, mund të kontaktoni drejtorinë komunale për bujqësi ose të kontaktoni Zyrtarin e projektit INTERDEV 2 në ndërtesën e Komunës në Vitisë, zyra nr. 6, Ndërtesa e Kadastrës.

Formularët origjinal duhet të dorëzohen, në kopje fizike, tek zyra e projektit INTERDEV 2 në Viti para ose deri me datën 19 Korrik 2019 në ora 16:00.

KUJDES: Ju lutemi mos harroni të merrni dokumentin që vërteton se e keni dorëzuar Formularin e Aplikimit dhe dokumentet shoqëruese në kohën e duhur

JU LUTEMI NA NDIHMONI të promovojmë këtë Thirrje për Aplikime duke informuar njerëz të tjerë që mendoni se mund të kenë interes të aplikojnë për këtë mundësi